V E N D I M
Nr.438, datë 26.6.2003

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KABINETIT TË MINISTRAVE TË UKRAINËS, PËR BASHKËPUNIM NË LUFTËN KUNDËR KRIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kabinetit të Ministrave të Ukrainës për bashkëpunimin në luftën kundër krimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KABINETIT TË MINISTRAVE TË UKRAINËS MBI BASHKËPUNIMIN NË LUFTËN KUNDËR KRIMIT

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kabineti i Ministrave të Ukrainës, të quajtura më poshtë si "Palë Kontraktuese":

duke qenë të shqetësuar për rritjen e kriminalitetit, në mënyrë të veçantë të krimit të organizuar;

duke i dhënë rëndësi të madhe bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse për sigurinë dhe ruajtjen e ligjit dhe të rendit me qëllim që të luftohen në mënyrë efektive të gjitha llojet e kriminalitetit, në mënyrë të veçantë të krimit të organizuar;

duke u përpjekur për të krijuar rregullat dhe format optimale përsa i përket veprimtarive operative, ashtu si edhe për të përdorur masa parandaluese nga ana e organizmave të përmendur;

duke marrë parasysh kërkesën për të mbikëqyrur rregullat e së drejtës ndërkombëtare dhe dispozitat e legjislacionit shtetëror, bazuar në parimet e barazisë, respektit dhe përfitimit reciprok;

duke dëshiruar përshtatjen e veprimtarive të saj kundër krimit të organizuar ndërkombëtar në lidhje me kushtet aktuale;

duke nxitur zbatimin e Konventës europiane mbi asistencën e përbashkët në çështjet penale (1959), Konventës europiane për ndalimin e terrorizmit (1977), Konventës mbi pastrimin, kërkimin, bllokimin dhe konfiskimin e produkteve që rrjedhin nga krimi (1990), Konventës europiane mbi ekstradimin (1957) dhe Konventës europiane mbi transferimin e procedurave gjyqësore në çështjet e kriminalitetit (1972),

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

1. Palët Kontraktuese do të bashkëpunojnë në përputhje me legjislacionet e tyre shtetërore në sferat e mëposhtme:

1) lufta kundër terrorizmit, parandalimi i aktiviteteve që financojnë terrorizmin;

2) lufta kundër krimit të organizuar;

3) lufta kundër trafikimit të paligjshëm të armëve, municionit, lëndëve plasëse dhe atyre toksike, materialeve dhe teknologjive me përdorim të mundshëm të dyfishtë (ushtarake dhe civile), lëndëve bërthamore dhe burimeve të rrezatimit jonizues;

4) lufta kundër trafikimit të paligjshëm të drogave, lëndëve narkotike, lëndëve psikotrope dhe prekursorëve;

5) lufta kundër falsifikimit të parave dhe mjeteve të tjera të pagesës, elementeve të sigurisë, dokumenteve financiare, futjes së tyre në qarkullim dhe përdorimit të paligjshëm të tyre;

6) lufta kundër krimeve në sferat ekonomike dhe financiare, duke përfshirë krimet që kanë të bëjnë me evazionin fiskal, legalizimin e të ardhurave nga krimi dhe korrupsioni;

7) lufta kundër kontrabandës dhe shkeljeve apo kundërvajtjeve në taksimin doganor;

8) lufta kundër krimeve ndaj individëve;

9) lufta kundër krimeve ndaj pronës;

10) lufta kundër krimeve, objektet e të cilave janë vlerat historike dhe kulturore dhe produktet e metaleve dhe mineraleve të çmuara;

11) lufta kundër vjedhjeve dhe trafikimit të paligjshëm të mjeteve të transportit;

12) lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore me qëllim shfrytëzimin seksual të tyre;

13) lufta kundër migracionit të paligjshëm;

14) lufta kundër krimeve në fushën e kibernetikës;

15) kërkimi i njerëzve të humbur, identifikimi i personave të panjohur, si dhe identifikimi i kufomave të paidenfikuara;

16) kërkimi i personave që dyshohen ose akuzohen për kryerjen e një krimi, ashtu si edhe personave që i shmangen përgjegjësisë për kryerjen e krimit ose shlyerjes së dënimit.

2. Bashkëpunimi i ndërsjellë i Palëve Kontraktuese duhet të kryhet në përputhje me normat e legjislacionit të tyre në fuqi pikësëpari në formën:

1) e përmbushjes së masave të përmendura në kërkesat dhe të lejuara nga legjislacioni i palës së kërkuar;

2) e shkëmbimit të materialeve, informacionit shkencor dhe teknik dhe i rezultateve të ekspertizave;

3) e shkëmbimit të informacionit në lidhje me sistemet e regjistrimeve (dokumentimeve) operacionale dhe atyre gjyqësore dhe mundësive për përdorimin e tij;

4) e shkëmbimit të përvojës dhe bashkëpunimit në sferën e trajnimit profesional të specialistëve;

5) e shkëmbimit të informacionit në lidhje me organizatat kriminale që veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe të Ukrainës;

6) e shkëmbimit të akteve legjislative dhe të akteve të tjera normative të Palëve Kontraktuese, që ndihmojnë në sigurimin e literaturës mësimore dhe rekomandimeve metodologjike;

7) e takimeve periodike të përfaqësuesve të autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese për analizimin e bashkëpunimit në të gjitha sferat dhe nivelet;

8) e dhënies së aparaturave të posaçme, që përdoren në luftën kundër krimit.

3. Kërkesat e parashikuara nga kjo Marrëveshje dhe përgjigjet ndaj tyre duhet të bëhen me shkrim. Në rastet urgjente kërkesa mund të bëhet me gojë dhe duhet të konfirmohet pa vonesë me shkrim.

4. Kjo Marrëveshje nuk do të pengojë Palët Kontraktuese për të krijuar dhe zhvilluar forma të tjera bashkëpunimi.

Neni 2

1. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese përgjegjëse për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje janë:

Në Republikën e Shqipërisë:

- Ministria e Rendit Publik,

- Prokuroria e Përgjithshme
- Shërbimi Informativ Shtetëror
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Në Ukrainë:

- Ministria e Punëve të Brendshme
- Prokuroria e Përgjithshme
- Shërbimi i Sigurimit
- Komiteti i Rojës së Kufirit Shtetëror të Ukrainës
- Administrata e Taksave Shtetërore
- Shërbimi Shtetëror i Doganave

1) Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese do të organizojnë takime të ekspertëve me qëllim vlerësimin e bashkëpunimit dhe përmirësimit të tij.

2) Me qëllim realizimin e dispozitave të Marrëveshjes, autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese mund të përfundojnë protokolle shtesë, të cilat do të specifikojnë drejtimet konkrete të bashkëpunimit dhe rrugët e kontakteve.

Neni 3

1. Në përputhje me këtë Marrëveshje respektimi i standardeve ligjore të shtetit të kërkuar është i detyrueshëm në kuadrin e bashkëpunimit.

2. Me qëllim të koordinimit të aktiviteteve brenda zbulimit të krimeve, autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese mund të dërgojnë përfaqësuesit e tyre në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 4

Me qëllim garantimin e konfidencialitetit të të dhënave personale, të cilat janë transferuar reciprokisht në kuadrin e bashkëpunimit të shqyrtuara nga kjo Marrëveshje në përputhje me legjislacionin në fuqi në vendet e tyre, Palët Kontraktuese do të respektojnë këto kushte:

1. Pala Kontraktuese, e cila merr të dhënat mund t'i përdorë ato vetëm me qëllim dhe sipas kushteve, të përcaktuara nga Pala Kontraktuese që ia dha ato.

2. Pala Kontraktuese, e cila merr të dhënat do të informojë Palën Kontraktuese që i dha ato lidhur me përdorimin e tyre dhe rezultatet e arritura.

3. Të dhënat personale mund t'u dërgohen vetëm autoriteteve shtetërore, përgjegjëse për sigurinë dhe rendin publik. Transferimi i të dhënave organeve të tjera, shtetit të tretë ose personave fizikë dhe juridikë do të lejohet vetëm mbi bazën e marrëveshjes me shkrim të Palës Kontraktuese që i dha ato të dhëna.

4. Pala Kontraktuese, që i dha të dhënat, do të marrë një vendim lidhur me domosdoshmërinë dhe dobinë e dhënies së tyre dhe do të bëjë të interesohet rreth autenticitetit dhe saktësisë së tyre. Përveç kësaj është e nevojshme për t'u ballafaquar me legjislacionin kombëtar të shtetit të Palës tjetër Kontraktuese që kufizon ose ndalon këtë dorëzim të dhënash. Nëse mësohet se të dhënat e siguruara nuk janë të besueshme ose janë të ndaluara për t'u transferuar, është e nevojshme të informohet Pala Kontraktuese që mori atë informacion. Pala Kontraktuese, që mori informacionin është e detyruar të saktësojë informacionin jo të besueshëm dhe t'i fshijë ato të dhëna që ndalohen për t'u transferuar.

5. Personi, të dhënat personale të të cilit do të jepen ose janë dhënë mbi bazën e kërkesës së atij personi, do të informohet lidhur me transferimin e të dhënave dhe qëllimet e përdorimit të tyre, në rast se kjo gjë lejohet nga legjislacioni kombëtar i të dyja Palëve Kontraktuese.

6. Pala Kontraktuese që jep informacionin do të njoftojë Palën tjetër Kontraktuese në lidhje me kushtet e asgjësimit e atij informacioni, të cilat parashikohen nga normat legjislative të shtetit përkatës. Pavarësisht nga ato kushte, të dhënat personale duhet të asgjësohen kur është e nevojshme.

Neni 5

1. Çdo Palë Kontraktuese mund të refuzojë plotësisht ose pjesërisht të japë asistencë ose

bashkëpunim në formën e dhënies së informacionit ose përmbushjes së akteve (dokumenteve) të tjera, nëse kjo gjë konsiderohet një kërcënim për sovranitetin, sigurinë ose interesa të tjera themelore të shtetit të saj ose bie ndesh me legjislacionin e saj kombëtar dhe detyrimet në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare.

2. Në rastet e përcaktuara nga pika 1 e këtij neni, Palët Kontraktuese do të informojnë njëra-tjetrën menjëherë rreth refuzimit në dhënien e asistencës dhe të shpjegojë arsyet e refuzimit.

Neni 6

1. Çdo Palë Kontraktuese mund të negociojë rreth kushteve të caktuara për dhënien e asistencës, të cilat janë të detyrueshme për Palën tjetër Kontraktuese.

2. Çdo Palë Kontraktuese do të garantojë fshehtësinë e informacionit të marrë nga Pala tjetër Kontraktuese, nëse ky informacion ka karakter konfidencial në përputhje me normat e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese dhe specifikohet si konfidencial.

3. Materialet, informacioni, teknikat dhe mjetet e tjera të paraqitura mbi bazë të kësaj Marrëveshjeje, mund t'u transferohen shteteve të treta, në qoftë se Pala Kontraktuese që i dha ato konfirmon me shkrim pëlqimin e saj.

4. Çdo shkëmbim i informacionit që është sekret do të kryhet pasi të jetë miratuar dhe hyrë në fuqi Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Kabinetit të Ministrave të Ukrainës, në fushën e mbrojtjes së ndërsjellë të informacionit sekret dhe duhet të plotësojë kërkesat e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 7

Çdo Palë Kontraktuese do të përballojë kostot, që lidhen me zbatim e kësaj Marrëveshjeje në territorin e vet, nëse ato nuk arrijnë ndonjë marrëveshje tjetër.

Neni 8

Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese do të bashkëpunojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe në mënyrë operative brenda kuadrit të kompetencës së tyre në drejtim të realizimit të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me nenin 2.

Neni 9

Në kuadrin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, Palët Kontraktuese do të përdorin gjuhën shqipe, ukrainase dhe angleze, nëse ato nuk bien dakord për gjuhë tjetër.

Neni 10

Kjo Marrëveshje nuk do të pengojë të drejtat dhe detyrimet e Palëve Kontraktuese në përputhje me marrëveshjet e tjera ndërkombëtare, të firmosura nga ato.

Neni 11

1. Kjo Marrëveshje do të ketë efekt për një periudhë të pacaktuar dhe do të hyjë në fuqi nga data, kur është marrë njoftimi i fundit me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike që të gjitha parakushtet që kërkohen nga legjislacioni ekzistues në vendin e Palës, janë plotësuar për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Mbi bazën e marrëveshjes së ndërsjellë, Palët Kontraktuese mund ta amendojnë me shkrim këtë Marrëveshje. Këto amendamente do të hyjnë në fuqi në përputhje me procedurën e përmendur në paragrafin 1.

3. Kjo Marrëveshje mund të denoncohet nga secila prej Palëve Kontraktuese. Në këtë rast ajo nuk do të ketë më efekt gjashtë muaj pas datës së marrjes së njoftimit me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike rreth prishjes së kësaj Marrëveshjeje nga ana e Palës tjetër Kontraktuese.

Bërë në Kiev, më 27 maj 2003 në dy kopje origjinale, secila kopje në gjuhën shqipe, ukrainase dhe angleze, të gjitha tekstet janë autentike. Në rast kontradiktash në interpretim do të merret për bazë teksti në anglisht.